



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 147/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektoriati i Punës, me seli në Prishtinë, rr. “Qamil Hoxha”, kundër debitorit “A...” sh.p.k., me NRB:... dhe NRF:..., me seli në fshatin, Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 2868/18 të datës 25.10.2018 të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 25.08.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “A...” sh.p.k, me seli në fshatin, Komuna e Fushë Kosovës, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 2868/18, të datës 25.10.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj.

II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.2868/18, i datës 25.10.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektoriati i Punës.

A r s y e t i m

Kreditori, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektoriati i Punës ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit “A...” sh.p.k, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – Vendimi 01.Nr.40-54-18/A, i datës 05.06.2018, i formës së prerë me datë 30.08.2018 dhe i ekzekutueshëm me datë 30.08.2018, me

të cilët debitori është obliguar që kreditorit në emër të masës ndëshkimore t'ia paguaj shumën prej 1,000.00€ (një mijë euro) në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të vendimit në xhirollogarinë Nr..... B.Q.K., sipas numrit të Vendimit.

Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektoriati i Punës, me datë 25.10.2018, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.2868/18, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Vendimit të Inspektoratit të Punës 01.Nr.40-54-18/A, të datës 05.06.2018. Kreditori në propozimin për përmbarim të datës 25.10.2018, ka kërkuar që të detyrohet debitori “A...” sh.p.k., me seli në fshatin, Komuna e Fushë Kosovës, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit-Inspektoratit të Punës, në emër të masës ndëshkimore shumën prej 1,000.00 € (një mijë euro), nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe mjeteve të luajtshme në pronësi të tij, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori “A...” sh.p.k., brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, në të cilin ka theksuar se vendimi në bazë të cilit është lejuar përmbarimi nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, sepse i njëjti është bazuar në kontratën për kryerjen e punimeve në të cilën nuk është specifikuar se kush e bart përgjegjësinë për sigurinë dhe shëndetin në punë në rast aksidenti. Tutje ka shtuar se përgjegjësia në rastin konkret bie mbi punëkryesin N.N.P. “P...” e jo mbi investitorin. Sipas kontratës për kryerjen e punimeve debitori nuk është përgjegjës për mos sigurimin e vendit të punimeve e as të ndërmarrë masa për parandalimin e rreziqeve, sepse kjo ka qenë detyrë e punëkryesit N.N.P. “P...”, ngase punëtorët e aksidentuar kanë qenë të siguruar te punëkryesi, andaj për këto arsye urdhri për përmbarim nuk është i bazuar në ligj sepse në rastin konkret nuk është fajtor debitori, por punëkryesi. Prandaj duke qenë se nuk është vërtetuar se kush është përgjegjës për lëndimin e punëtorëve, ka kërkuar që procedura të fillohet sipas padisë ndërsa të ndërpritet procedura përmbarimore derisa të vendoset për këtë çështje. I ka propozuar gjykatës që kundërshtimi i debitorit të aprovohet ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet dhe të pezullohet procedura e përmbarimit, ngase urdhri është i kundërligjshëm.

Kreditori me përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar për shkak se propozimi për përmbarim është paraqitur pasi që debitori nuk e ka

përbushur detyrimin për pagesën e gjobës të shqiptuar me Vendimin 01 Nr.40-54-18/A të Inspektoratit të Punës, andaj kreditori është detyruar që të njejtin ta kërkoj përmes procedurës së përmbartimit. Po ashtu i ka kundërshtuar thëniet e debitorit se në këtë rast mungon baza juridike për përmbartim sepse procedura është zhvilluar në përputhje me dispozitat e LPP-së, si dhe Inspektorati i Punës i ka zbatuar dispozitat ligjore në mënyrë të drejtë dhe drejtë ëshë vërtetuar gjendja faktike. Ka shtuar se mbetet pranë propozimit të dhënë duke kërkuar nga gjykata që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata konstaton se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbartimor Vendimin 01 Nr.40-54/2018/A, në bazë të të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafit paragrafit 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Vendimi 01 Nr.40-54/2018/A, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit”,* pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimin 01 Nr.40-54/2018/A, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues,*

original apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: “Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”, ngase Vendimi 01 Nr.40-54-18/A, i datës 05.06.2018, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 30.08.2018 dhe i ekzekutueshëm me datë 30.08.2018.

Gjykata po ashtu i vlerësoi edhe pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se nga kontrata për kryerjen e punimeve nuk është specifikuar se kush e bartë përgjegjësinë për sigurimin dhe shëndetin në punë në rast të aksidentit andaj në rastin konkret përgjegjësia duhet të bie mbi punëkryesin e jo mbi investitorin mirëpo gjeti se të njëjat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së

Nga arsyet e paraqitura më lartë, në bazë të nenit 21, 22 par.1 pika 1.2, 27, 36 par.1 dhe 2 dhe 73 par.3 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.147/22, datë 25.08.2022

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.